



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 195, datë 09.06.2021

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR PROKURORË PRANË
PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR TË CILËT PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 7 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenin 47/1/b dhe 48/1 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar si dhe në nenin 12 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", i ndryshuar, miratuar me Vendimin nr. 51, datë 19.03.2019, me propozim të Komisionit të Posaçëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës me emrat e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për ngritjen në detyrë pas vlerësimit paraprak, sipas rendit alfabetik më poshtë;
 - Adnand XHOLI
 - Dorina BEJKO
2. Relacioni shoqërues është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Kandidatët e listuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të vazhdojnë garën e mëtejshme për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**





ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ